# DËSHMI ARKIVI

**A-476979**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 2

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Messi shënon golin spektakolar nga goditja e dënimit, vetëm dy gola larg rekordit - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/messi-shenon-golin-spektakolar-nga-goditja-e-denimit-etem-dy-gola-larg-rekordit/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 16:28:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 16:26:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `57f1a0f5b172b184681c709f5f31a2db8b8e2af69fcd48f4e8ba6278550767e8` |
| TEKSTI | `f20b920300dc43b68783654440d3a310002da03d25235d2e8a90fb600595ca55` |
| PAMJA | `377003fc244edd503c9bf85212721ed545f50278bfc038602ab322413f0ebc01` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e51d35626a1e05d9b225daa594a42d4357022085283129499060f504332d1fd3` |
| E MËPARSHMJA | `8f632bda08e602512ae2574200f529ee103d7edf6d7725c49eee3cfa8d2c4a0f` |
| RRËNJA MERKLE | `1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e51d35626a1e05d9b225daa594a42d4357022085283129499060f504332d1fd3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Messi shënon golin spektakolar nga goditja e dënimit, vetëm dy gola larg rekordit

28 Shtator 2026 | 18:26

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Lionel Messi vazhdon ta bëjë të zakonshmen diçka të jashtëzakonshme.

Argjentinasi shënoi një tjetër gol spektakolar nga goditja e dënimit në ndeshjen e Inter Miamit ndaj Columbus Crew, duke e çuar në 76 numrin e golave nga goditjet e lira direkte në karrierë.

Messi tani është vetëm dy gola larg shifrës së 78 golave, që i atribuohet gjerësisht brazilianit Marcelinho Carioca.

Por mënyra se si erdhi goli është ndoshta edhe më interesante se vetë rekordi.

Në minutën e 33-të, Messi e mori goditjen e dënimit rreth shtatë metra larg vijës fundore, në anën e djathtë të fushës. Pozicioni dukej shumë më i përshtatshëm për një krosim në zonë sesa për një goditje direkte.

Messi mendoi ndryshe.

Me të majtën, ai e ngriti topin mbi mur dhe e dërgoi në këndin e largët, nën traversë, duke e lënë portierin e Columbusit, Patrick Schulte, të shtrirë pa mundësi reale për ta ndalur. Ishte edhe goli i tij i 21-të në MLS këtë sezon.

Edhe vetë Schulte e pranoi vështirësinë e përballjes me një lojtar të tillë.

“Të ndash fushën me të është padyshim e pabesueshme, por do të preferoja që të mos shënonte kundër meje. Gjithsesi, jam sinqerisht i lumtur që në fund morëm tri pikët”, deklaroi portieri i Columbus Creë.

Dhe këtu qëndron një nga statistikat më të veçanta të evolucionit të Messit.

Që nga viti 2018, Messi ka shënuar më shumë gola nga goditjet e lira direkte sesa nga penalltitë: 36 gola nga goditjet e dënimit, kundrejt 35 nga pika e bardhë, sipas statistikave të publikuara nga beIN SPORTS dhe Mundo Deportivo.

LAJMI I FUNDIT

20:05 Sulm ajror në një treg në Myanmar, 33 të vrarë dhe 36 të plagosur (VIDEO)

20:04 Senati italian miratoi ligjin për futjen e energjisë bërthamore në sistemin energjetik

19:57 Marrëveshja e arit venezuelian e mbështetur nga SHBA, mbetet në depo për shkak të dyshimeve për origjinë kriminale

19:52 Britania hap rrugë të reja ligjore për refugjatët

19:47 Thirrja për masa kundër Ebolës i kushtoi jetën, politikani rrihet për vdekje në Kongo

19:29 Komandanti i NATO-s raporton te parlamentarët evropianë: Qëllimi i Rusisë është të thyejë vullnetin e aleatëve të Ukrainës



**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

SPORT

### Persona të panjohur vandalizuan grafitet e Franco Baresi-t në Milano

Persona të panjohur kanë vandalizuar zyrat e AC Milan në Milano, një akt që ka shkaktuar zemërim në Itali. Grafiti i Franco Baresi -t në...

13:59 | 28/09/2026

SPORT

### Kombëtarja mbyll përgatitjet në "Shtëpinë e Futbollit" për ndeshjen ndaj San Marinos

Kombëtarja shqiptare ka mbyllur përgatitjet për ndeshjen e dytë në UEFA Nations League ndaj San Marinos, që do të luhet nesër në orën 20:45, në...

13:03 | 28/09/2026

SPORT

### Ronaldo u la në stol, Portugalia fiton 2-1 ndaj Norvegjisë

Erling Haaland shënoi golin e tij të 65-të ndërkombëtar për Norvegjinë, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të rrëmbyer fitoren ndaj Portugalisë. Pasi Joao...

10:50 | 28/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.